



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 94-të të mbajtur më 13.10.2023, ka miratuar sa vijon.

Vendim

Denoncimi me numër 12-1548/1 nga 04.03.2022, me pretendime për ngjarjet në ///, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent sepse pretendimet në kërkesën në fjalë kanë të bëjnë me çështje që nuk i nënshtrohen veprimit kompetent të saj.

Lënda me numër 12-1548/1 nga 04.03.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 04.03.2022, një parashtrues i njohur ka paraqitur një kërkesë, sipas së cilës është konstatuar lënda nr. 12-1548/1 nga 04.03.2022 ///, lidhur me pengesat e drejtorit të Shërbimit Gjeologjik në procedurën e auditimit të dokumentacionit gjeologjik.

Në denoncim thuhet se në procedurën për auditimin e dokumentacionit gjeologjik, e cila kryhet në Shërbimin Gjeologjik, janë bërë pengesa nga drejtori i Shërbimit Gjeologjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut -----, me formimin e parakohshëm të Komisioneve për auditimin (ekspertimin) e dokumentacionit gjeologjik dhe në procedurat e vetë komisioneve që kanë dhënë komente, dhe me pengesa të tilla kompanitë private që u kryen kërkime dhe prova gjeologjike, hidrogjeologjike dhe u përgatit atyre dokumentacionin gjeologjik për këtë, u vu në një situatë të palakmueshme para investitorëve.

Parashtruesi kërkon hapjen e procedurës për rastin e përmendur për zbulimin e saktë të parregullsive në Institutin Gjeologjik.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se në rastin konkret bëhet fjalë për pretendime për çështje që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent dhe parashtruesi i kërkesës në lidhje me rastin t'i drejtohet Inspektoratit Administrativ Shtetëror dhe të kërkojë që ka vepruar sipas autoritetit të

tij. Nga aty KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në këtë rast dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar: parashtruesi i denoncimit
Përgatiti: J.C
Miratoi: G.T., Anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHETËTOR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

